

QERSHOR 2021

NEWSLETTER



Marrëveshje bashkëpunimi

**AAB NËNSHKROI MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME IATP
(INTEGRATED AGRICULTURAL TECHNOLOGY AGENCY)**

**FILLON JETËSIMI I MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIT ME
UNIVERSITETIN "ISA BOLETINI"**

**NËNSHKRUHET MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME UNIVERSITETIN
"FEHMI AGANI"**



Shkëmbim akademik

**PROFESORESHA NGA FRANCA, DR. MARIEL LECLERE U LIGJËROI STUDENTËVE
TË AAB-SË PËR ELEKTROENCEFALOGRAFINË DHE NEURO-FEEDBACK-UN**



Aktivitete shkencore

**AAB LANSOJ PROJEKTIN HULUMTUES PËR NDIKIMIN E TEKNOLOGJISË
INFORMATIVE DHE MEDIAVE NË SHËNDETIN MENDOR**

STUDENTËT E KRIMINALISTIKËS, PJESË E PROJEKTIT HULUMTUES ISRD4



Storje suksesi

**ISH-STUDENTI I AAB-SË, FITUES I ÇMITIT KRYESOR "INOVACIONI I VITIT"
SI ZHVILLUES I PLATFORMËS IBAS NË KOMPANINË PBC**

**SHKURTA DHE MIRLINDA, INFERMIERET E DIPLOMUARA NË AAB E TË
PUNËSUARA NË GJERMANI**



Akademi Solemne

**KOLEGJI AAB MBAJTI AKADEMI NË 85 VJETORIN E LINDJES SË
AKADEMIKUT REXHEP QOSJA**

**ÇMIMI NDËRKOMBËTAR PËR LETËRSI "ALI PODRIMJA" I KOLEGJIT AAB
PËR VITIN 2021 IU NDA SHKRIMTARIT BOSHNIJAK ABDULAH SIDRAN**

AAB NËNSHKROI MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME IATP (INTEGRATED AGRICULTURAL TECHNOLOGY AGENCY)

1 Qershor 2021

Kolegji AAB nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me IATP-Integrated Agricultural Technology Agency L.L.C. për të promovuar bashkëpunimin e përbashkët edukativ e kulturor.

Palët kanë rënë dakord se lëvizjen drejt mësimit gjatë gjithë jetës duhet ta shoqërojë një tranzicion i suksesshëm në ekonominë dhe shoqërinë e bazuar në dije.



Prandaj, promovimi i qytetarisë aktive dhe punsueshmërisë janë qëllime të këtij memorandumit, dhe shihen si po aq të rëndësishme dhe të ndërlidhura për mësimin gjatë gjithë jetës, e ku do të duhej të përfshihen të gjitha format e mësimdhënies dhe të të mësuarit.



Kjo do të arrihet përmes organizimit të përbashkët të kurseve, punëtorive, trajnimeve ndërkombëtare, etj.. Pjesë e marrëveshjes me IATP do të jetë edhe Instituti AAB për Kontabilist dhe Auditorë të Certifikuar që operon në kuadër të Kolegjit AAB.



STUDENTËT E NIVELIT MASTER DISKUTUAN PËR SHËRBIMET LOGJISTIKE DHE TRANSPORTIN NË TREGUN VENDOR ME BIZNESMENIN AHMET DOBRUNAJ

3 Qershor 2021

Pronari i Kompanisë “Artida LD”, z. Ahmet Dobrunaj, ishte i ftuari i radhës, në cilësinë e folësit mysafir në kuadër të modulit “Menaxhimi i Furnizimit Zinxhiror”, që është pjesë e kurrikulës së programit master Marketing dhe Menaxhim Biznesi.

Qëllimi i organizimit të këtij aktivitetit ishte njoftimi me praktikantët e funksionimit të logjistikës së kompanive kosovare, duke ndarë përvojat konkrete me kompaninë vendore “Artida LD”.

Diskutimi në këtë aktivitet u përqendrua në menaxhimin klasik të viteve të kaluara të logjistikës, si dhe ndryshimet e tanishme me sistemet e reja të digjitalizuara.

Studentët në këtë ligjëratë u njoftuan edhe për sidat e importimit të mallrave nga vendet e ndryshme ndërkombëtare, distribuimin e tyre në tregun vendor dhe mundësitë e eksportimit në tregun regional dhe ndërkombëtar.



Edhe sfidat e krijuara me pandeminë Covid-19 ishin temë e veçantë diskutimi, duke pasur parasysh problemet dhe vonesat që ka krijuar në shërbimet logjistike.



Kompania Artida LD është një kompani e suksesshme kosovare e themeluar në vitin 1990, ndërsa nga viti 1998 merret edhe me shërbimet e eksportit dhe importit.

Veprimtaria kryesore e kompanisë është tregtia me shumicë e artikujve të imët metalikë, materialit instalues dhe pajisjes së ujësjellësit dhe ngrohjes.

FILLON JETËSIMI I MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT ME UNIVERSITETIN “ISA BOLETINI”

3 Qershor 2021

Rektori i Kolegjit AAB, Bujar Demjaha, me bashkëpunëtorët e tij pritën në takim pune përfaqësuesit e Universitetit “Isa Boletini” nga Mitrovica, prof.dr. Behxhet Shala, prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Hulumtime dhe prof.ass.dr. Besim Golloperi, dekan i Fakultetit të Edukimit.



Qëllimi i këtij takimi ishte jetësimi i marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar para pak kohe. Në këtë takim u diskutuan tema me interes të përgjithshëm e në veçanti koordinimi i një sesioni të përbashkët në kuadër të konferencës që do të zhvillohet në nëntor (2021) në Universitetin e Korçës,

së bashku me Institutin Shqiptar të Sociologjisë (Tiranë) dhe institucionet të tjera partnere. Përveç kësaj, në takim u diskutua edhe për hapat e mëtejshme rreth organizimit të konferencave shkencore, por edhe ligjëratave speciale për studentë.

Në takim morën pjesë edhe prof.ass.dr. Venera Lljuni, prorektore për Bashkëpunim dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, dr.sc. Urela Demaj, prorektore për Shkencë dhe Hulumtime dhe Ilirjana Geci, drejtoreshë për Zhvillim të Projekteve ERASMUS+, nga Kolegji AAB.

STUDENTËT E FAKULTETIT EKONOMIK PREZANTUAN PROJEKTET E TYRE IDEORE PËR KRIJIMIN E BIZNESEVE TË REJA

4 Qershor 2021

Ide inovative për aktivitete të ndryshme biznesore, organizative, investive, teknologjike, sensibilizuese përmes projekteve të hartuara nga studentët, ishin pjesë e prezantimeve publike të studentëve të Fakultetit Ekonomik.

Studentët të ndarë në ekipe bënë prezentimin e projekteve të punuara në mënyrë të pavarur në fusha të ndryshme si në sferën e marketingut, biznesit, të teknologjisë informative, edukative, etj., duke dëshmuar njohje të identifikimit dhe planifikimit të aktiviteteve të nevojshme të secilës fazë të projektit, të përcaktimit të resurseve të nevojshme, të përcaktimit të kohëzgjatjes të secilit aktivitet, të përcaktimit të koston dhe rreziqeve të projektit.

Gjatë këtij procesi, studentët, poashtu treguan shkathtësi në aplikimin e metodave, mjeteve dhe teknikave të menaxhimit të fushëveprimit, kohës, burimeve njerëzore, koston, dhe riskut të projekteve.

Udhëheqëset e këtij aktiviteti, prof.Florije Miftari e prof.Erblina Pira, u shprehën të kënaqura me përgjithësimin e studentëve në prezentimin e projekteve, duke theksuar se studentët përmes këtij prezantimi dëshmuar se si njohuritë teorike aplikohen në praktikë.



Përfaqësuesit të grupeve ishin:

Kaltrina Muqaj, Leuarta Rama, Besjana Martini, Donika Beqiri, Tringa Fushtica, Liridon Konjushveci, Erind Govori, Luljeta Gashi, Artë Hoxha, Agnesa Tullari, Shkodran Derguti, Vegim Begolli, Nazmie Morina.

AAB LANSOJË PROJEKTIN HULUMTUES PËR NDIKIMIN E TEKNOLOGJISË INFORMATIVE DHE MEDIAVE NË SHËNDETIN MENDOR

7 Qershor 2021

“AAB Summer Project” është projekti që AAB ka lansuar për studentët e vet, e që do të implementohet gjatë pushimeve verore 2021.

Kjo iniciativë do të grumbullojë studentët nga Fakultetet e Psikologjisë, Komunikimit Masiv dhe Shkencave Kompjuterike, në një projekt madhor hulumtues, me ç’ rast studentët, në bashkëpunim me stafin mësimdhënës, do të hulumtojnë tema të ndërlidhura me Ndikimin e teknologjisë informative dhe mediave në shëndetin mendor.

Qëllimi kryesor i këtij projekti është që tek studentët të zhvillojë kapacitetet hulumtuese, por gjithashtu, atyre t’u ofrojë një gamë të gjerë të aktiviteteve informuese dhe rekreative me të cilat ata do të mbeten të përfshirë në procesin edukativ edhe gjatë pushimeve verore.

Hulumtimet të cilat do të zhvillohen gjatë verës, synohet që të kurorëzohen me një konferencë shkencore e cila do të organizohet në Kolegjin AAB në muajin tetor 2021.



Përpos aktivitetit hulumtues, në kuadër të projektit, çdo javë, do të organizohen edhe aktivitete të tjera si ligjërata me profesionistë të fushave, shikim i filmave dhe aktivitete tjera rekreative. Në takimin e fillimit të projektit, morën pjesë përfaqësuesit e rektoratit të Kolegjit AAB dhe studentët hulumtues.



Me këtë rast dekani i Fakultetit të Psikologjisë Naim Telaku, në emër të tri fakulteteve, shpalosi idenë dhe specifikat e realizimit të projektit.

KOLEGJI AAB NËNSHKRUAN VAZHDIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT ME UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR MOISIU” NGA DURRËSI, SHQIPËRI

7 Qershor 2021

Kolegji AAB dhe Universiteti “Aleksandër Moisiu” nga Durrësi, Shqipëri, të përfaqësuar nga rektorët përkatës, Dr.Sc. Bujar Demjaha dhe Prof. Dr. Kseanela Sotirofski, kanë nënshkruar sot vazhdimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, me qëllim të thellimit të bashkëpunimit në mes të dy institucioneve.



Në ceremoninë e nënshkrimit, të mbajtur në ambientet e Universitetit “Aleksandër Moisiu” në Durrës, rektorët përkatës theksuan përfitimet reciproke të dy institucioneve të Arsimit të Lartë, që rrjedhin nga vendosja dhe zhvillimi i marrëdhënieve dhe bashkëpunimit reciprok.



Marrëveshja e nënshkruar parashikon ndër të tjera, shkëmbim të personelit akademik për mësimdhënie në lëndët e modulet me interes të përbashkët, programe studimi të përbashkëta, kualifikim të personelit akademik, nëpërmjet organizimit të seminareve, workshop-eve, konferencave shkencore, udhëheqjeve shkencore, organizimin dhe hartimin e programeve të përbashkëta, transferimin e studimeve dhe programeve sipas nevojave dhe interesit të përbashkët, bashkëpunimin për botime të përbashkëta akademike dhe periodike, shfrytëzimin e bibliotekave nga personeli akademik dhe studentët e dy institucioneve, etj..

Universiteti “Aleksandër Moisiu” në Durrës, është themeluar në vitin 2006. Në kuadër të këtij institucioni veprojnë 6 fakultete, ndërsa numëron rreth 20 mijë studentë në të tre ciklet e studimit.



KOLEGJI AAB DREJT THELLIMIT TË BASHKËPUNIMIT ME AMBASADËN E REPUBLIKËS SË KROACISË NË KOSOVË

9 Qershor 2021

Në Kolegjin AAB u mbajt takim pune mes Dr.Sc. Nedjeljko Spilek, Sekretar i parë në Ambasadën e Republikës së Kroacisë dhe Pro-rektoreve të Kolegjit AAB, Prof. Ass. Dr. Venera Llunji dhe Dr.Sc. Urela Demaj, dhe Drejtoreshës për zhvillim të projekteve, Ilirjana Geci.



Në takim u bisedua për raportet miqësore të cilat Kolegji AAB i ka me Ambasadën e Kroacisë dhe me ambasadorin e tyre, Sh.S. Danijela Barisic, por edhe me zyrtarë të Ambasadës kroate.

Qëllimi i takimit ishte krijimi i rrjetit bashkëpunues të Kolegjit AAB me universitetet në Kroaci me qëllim të promovimit të vlerave në fushën e arsimit të lartë.

Aty u theksua nevoja për bashkëpunime të tilla i cili do të rezultonte me organizime të përbashkëta të ngjarjeve të ndryshme akademike, shkencore dhe kulturore; aplikim në projekte të ndryshme shkencore dhe jo vetëm; organizim i aktiviteteve të ndryshme me studentë e sidomos me Unionin e studentëve dhe me studentët e diplomuar nga të dy vendet; promovim i librave dhe i aktiviteteve të ndryshme kulturore të cilat do të ishin nga Republika e Kroacisë.




KOLEGJI AAB PARTNER NË IMPLEMENTIMIN E PROJEKTIT “DISCOVER STEM FOR HER KOSOVO”

9 Qershor 2021

Dy profesorë të Kolegjit AAB, Prof.ass.dr.Arianit Maraj dhe Prof.ass.dr.Albulenë Kastrati, që të dy Fulbright Alumni, kanë fituar projektin “Discover STEM for Her Kosovo”, në kuadër të thirrjes së KUSA (Kosovo United States Alumni) në programin për grante të vogla.

Ky projekt i financuar nga Ambasada Amerikane në Prishtinë dhe i administruar nga KUSA, u zhvillua në partneritet me Kolegjin AAB, ndërsa ka për qëllim ngritjen e vetëdijesimit të vajzat për përfshirjen e tyre në profilet e shkencës, teknologjisë, inxhinierisë dhe matematikës (STEM).





Udhëheqësit e projektit, tregojnë se në kuadër të këtij projekti, deri tani janë mbajtur trajnime vetëdijesuese në gjashtë shkolla të mQesme në dy komuna, Rahovec në tri shkolla dhe në Kamenicë po ashtu në tri shkolla të mesme.

Përveç kësaj, njëra nga shkollat e mesme të Komunës së Kamenicës që janë përfshirë në këto trajnime, i përket minoritetit serb.

Projekti është drejt përfundimit, ndërsa në mbyllje të tij do të organizohet edhe një punëtori e cila do të zhvillohet në Kolegjin AAB, e ku krahas financuesve dhe administruesve të projektit, do të marrin pjesë edhe përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës, por edhe përfaqësuese gra të industrisë përkatëse.



STUDENTËT E KRIMINALISTIKËS NË AAB, PJESË E PROJEKTIT HULUMTUES ISRD4

10 Qershor 2021

Në kuadër të projektit hulumtues ndërkombëtar për delikuencën e të miturve, ISRD4 (The International Self-Report Delinquency Study), studentët e programit Kriminalistikë të Fakultetit Juridik të Kolegjit AAB, janë duke implementuar anketën me nxënës nëpër shkolla të ndryshme të komunave të Kosovës.

Ky projekt ndërkombëtar po zhvillohet në bashkëpunim me Asociacionin e Kriminologëve, Kriminalistëve dhe Viktimologëve të Kosovës (ASKK), së bashku me partnerët ndërkombëtarë Universitetin e Shkencave të Aplikuara të Cyrihut/ Institutin për Parandalimin e Delikuencës dhe Krimin, nga Zvicra; Kolegjin për Shkenca Sociale dhe



Humane, të Universitetit Northeastern nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës; dhe HETS-FR Shkollën për Punë Sociale.



Projekti ISRD4, që është vazhdimësi e tre edicioneve të mëparshme të këtij hulumtimi, dhe ka për qëllim paralajmërimin e hershëm lidhur me sjelljet devijante nga të miturit delikuede.

Në këtë hulumtim janë përfshirë grup moshat e fëmijëve nga 13-17 vjeç (nxënës nga klasa 7 deri në klasën e 12-të). Studentët e Kolegjit AAB të cilët janë duke realizuar hulumtimin në terren, po udhëhiqen nga prof. Mensut Ademi.

U MBAJT PUNËTORIA E RADHËS NË KUADËR TË PROJEKTIT VEROR “AAB SUMMER PROJECT”

14 Qershor 2021

Aktivitetet e përjavshme të Fakultetit të Psikologjisë, në kuadër të projektit veror “AAB Summer Project”, kanë vazhduar këtë javë me një ligjëratë tematike ku u fol për shërbimet psikologjike në Repartin e Gjinekologjisë në QKUK dhe në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Të ftuar në këtë aktivitet ishin Brikena Krasniqi-Hoti, psikoterapiste dhe specialiste e psikologjisë klinike dhe po ashtu Arbër Zeka, psikoterapeut me specializim në psikoterapi grupore dhe psikoterapi pozitive, i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës.



Të dy psikologët ndanë përvojat e tyre shumë të vlefshme gjatë praktikës në punë, ku nuk mungoi as interesimi i studentëve të cilët parashtruan pyetje të shumta në lidhje me temat e diskutuara.

Psikologja Brikena Krasniqi-Hoti theksoi se nevoja për psikolog në repartin gjinekologjik është tepër e rëndësishme duke pasur parasysh natyrën e brishtë të femrës, e cila vazhdimisht është në një lloj tranzicioni psikologjik që nga faza e shtatzënisë e deri në fazën pas-natale, dhe marrja e ndihmës psikologjike në këto raste është më se e nevojshme për mirëqenien e tyre psikologjike.

Po ashtu edhe psikologu Arbër Zeka, ndau mjaft informacione interesante duke shpalosur edhe njëherë rëndësinë e psikologut në Shërbimin Korrektues të Kosovës, i cili theksoi se vetëm në vitin 2020 ndihma psikologjike që kanë ofruar psikologët në këtë institucion ka ndikuar në parandalimin e vetëvrasjeve, ku sipas tij janë të regjistruara përafërsisht 40 tentim vetëvrasje nga të burgosurit.

Zeka potencoi se në vazhdimësi përditësohen statistika të ndryshme, të cilat janë edhe të publikuara online në webfaqen e institucionit relevant, ndërsa ftoi edhe studentët t' i përdorin ato për hulumtime të ndryshme në fushën e psikologjisë.



Nga ana tjetër, në kuadër të projektit "AAB Summer Project" studentët së bashku me mentorët përkatës diskutuan hapat e mëtejshëm të hulumtimeve. Dekani Naim Telaku potencoi rëndësinë e projektit ndërsa për sqarimet shitesë të metodologjisë është përkujdesur Prof. Shpend Voca. Tanimë, grupet hulumtuese janë në fazën e përzgjedhjes së temave dhe variablave përkatëse.

Në përmbyllje të aktivitetit të sotëm dekani Telaku paralajmëroi studentët dhe të pranishmit se në takimin e radhës do të jetë e ftuar psikologja ndërkombëtare Dr. Mariel Leclère e cila do të flasë për Elektroencefalogramin EEG dhe Neurofeedback.

ISH-STUDENTI I AAB-SË, FITUES I ÇMIMIT KRYESOR "INOVAZIONI I VITIT" SI ZHVILLUES I PLATFORMËS IBAS NË KOMPANINË PBC

14 Qershor 2021

Në edicionin e 9-të të garës më të madhe shqiptare në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit "ICT Awards", e cila u mbajt në Tiranë më 11 qershor, platforma IBAS fitoi çmimin kryesor atë të "Inovacionit të vitit".

Zhvillimin e kësaj platforme e ka bërë ish studenti i Kolegjit AAB, Yll Qarkaxhija, i cili tani është edhe ligjërues në Kolegjin AAB. Krahas kontributit të tij për gjeneratat e reja të studentëve në AAB, Ylli aktualisht është edhe menaxher në kompaninë PBC.

Me zhvillimin e platformës IBAS është synuar digjitalizimi i sistemit financiar në Kosovë, duke mundësuar që pagesat, transferet, kredi dhënit e produktet tjera të kryhen online.



KOLEGJI AAB NËNSHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME UNIVERSITETIN “FEHMI AGANI”

15 Qershor 2021

Në Rektoratin e Kolegjit AAB, sot u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit me Universitetin e Gjakovës “Fehmi Agani”.

Kjo marrëveshje përmes së cilës synohet thellimi i bashkëpunimit në fushën profesionale, arsimore e shkencore u nënshkrua nga Prorektorja për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Kolegjin AAB, prof.ass.dr. Venera Lljunji dhe Rektori i Universitetit “Fehmi Agani”, prof.ass.dr. Artan Nimani.



Me këtë rast, prorektorja Lljunji u shpreh e kënaqur për mundësinë e bashkëpunimit me Universitetin “Fehmi Agani” në Gjakovë.

“Presim rezultate konkrete nga bashkëpunimi ndërmjet institucioneve tona, kapacitetet e të cilave do të jenë në shërbim të stafit akademik dhe studentëve tanë”, tha ajo.

Nga ana tjetër, rektori Nimani shprehu bindjen se ky bashkëpunim do të jetë i frytshëm dhe do të prodhojë rezultat të prekshëm, që shtrihet në fushën e arsimit të lartë, hulumtimit dhe zhvillimit, aktiviteteve studentore dhe programeve relevante për komunitetin.



Përmes marrëveshjes së nënshkruar sot, pritet të krijohet partneritet në mes të palëve në fushën profesionale, arsimore dhe shkencore që përfshinë të gjitha programet e studimit të organizuara nga palët nënshkruese.

Marrëveshja konsiston në bashkëpunimin profesional mes stafit akademik dhe administrativ, bashkëpunimin e studentëve të cikleve të ndryshme të studimit për periudha semestrale studimi ose për periudha të praktikave, aktivitete dhe publikime të përbashkëta në kërkim shkencor etj..



PROFESORSHA NGA FRANCA, DR. MARIEL LECLERE U LIGJËROI STUDENTËVE TË AAB-SË PËR ELEKTROENCEFALOGRAFINË DHE NEURO-FEEDBACK-UN

18 Qershor 2021

Edhe këtë të javë, në Kolegjin AAB, kanë vazhduar aktivitetet në kuadër të 'AAB Summer Project'. Përpos pjesës organizative të projekteve hulumtuese, që do të zhvillohen gjatë verës, sot studentët e Fakultetit të Psikologjisë, Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe të ata të Fakultetit të Komunikimit Masiv, patën rastin të ndjekin një ligjëratë dhe demonstrim mjaft interesant nga profesoresha nga Franca, Dr. Mariel Leclere mbi elektroencefalografinë dhe neuro-feedback-un.

Gjatë kësaj ligjërate, studentët u njoftuan me këtë teknikë mjaft të avancuar të pasqyrit të valëve elektromagnetike të trurit të njohur si (EEG).

Dr. Leclere, prezantoi para studentëve fushat kryesore të aplikimit të kësaj teknike, e që përfshijnë pasqyrimi e valëve elektrike të trurit tek personat e zakonshëm, pastaj tek rastet klinike duke përfshirë çrregullimet e gjumit dhe jo vetëm, dhe pastaj bashkë me studentët operuan me aparaturën e EEG.



Prezantimi u mbyll me pasqyrimin e metodës së neuro-feedback përmes së cilës mund të intervenohet në rregullimin e valëve trunore në raste të çrregullimeve mendore. Në pjesën e fundit, studentët parashtruan pyetje nga kureshtja e tyre për imazhimin e punës së trurit përmes EEG dhe metodat e hulumtimit në kuadër të Neuroshkencës.



Aktiviteti u përmbyll me punëtorinë për projektet hulumtuese dhe me diskutimin e programit për javët në vazhdim.

KOLEGJI AAB DHE POLIKLINIKA E LABORATORI “AVICENA” NËNSHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

18 Qershor 2021

Studentët e Fakultetit të Infermierisë, të Kolegjit AAB, vazhdojnë të jenë kuadro të kërkuara brenda dhe jashtë vendit.

Me qëllim të angazhimit në praktika profesionale dhe punësimit të të diplomuarve në Infermieri, sot në Kolegjin AAB u nënshkrua edhe një marrëveshje bashkëpunimi me Laboratorin dhe Poliklinikën “Avicena”.

Prorektorja Venera LLunji, e cila në emër të Kolegjit AAB ishte nënshkruese e kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi, e cilësoi atë si shumë të rëndësishme: “Bashkëpunimi ynë shënon një hap të ri në fushën e mjekësisë. Në këtë rast kemi të bëjmë me ofrimin e kushteve profesionale për studentët tanë meqenëse kemi studentë të shkëlqyer dhe shpreosj që bashkëpunimi do të jetë në nivel të duhur”, tha LLunji.



Ajo sqaroi se me këtë marrëveshje studentët do të përfitojnë edhe nga trajnimet dhe seminarët profesionale. Ndërsa, Adelina Shuki, drejtoreshë gjenerale e Labororit “Avienca” u shpreh se marrëveshja me AAB-në për ta është e një rëndësie të veçantë: “Laboratori ynë është lider dhe dita ditës po zgjerohemi. Ne i kushtojmë rëndësi stafit profesional, andaj marrëveshja me AAB-në është shumë e rëndësishme për ne”, tha Shuki.

Kujtojmë se shumë nga studentët e diplomuar në Fakultetin e Infermierisë, në Kolegjin AAB, tashmë janë bërë pjesë e institucioneve të rëndësishme shëndetësore, jashtë vendit, ndërsa edhe më i madh është numri i atyre që janë punësuar në vendin tonë.

NË SHËNIM TË DITËS OLIMPIKE NDËRKOMBËTARE, STUDENTËT E AAB-SË U NGJITËN NË MAJËN E LUBOTENIT

23 Qershor 2021

Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit në Kolegjin AAB ka shënuar 23 Qershorin, Ditën Olimpikë Ndërkombëtare, me ngjitje në majën e Lubotenit.

Kjo majë llogaritet si një ndër pikat më të larta në vendin tonë me një lartësi mbidetare prej 2,498 metrash.



Në ekspeditën e organizuar me këtë rast, e që për Kolegjin AAB tashmë ka kaluar në traditë të përvitshme, morën pjesë profesorë dhe studentë të Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit. Këtë vit ky aktivitet u mbështet edhe nga Komiteti Olimpik i Kosovës.



Shënimi i Ditës Olimpike Ndërkombëtare me ngjitje në majën e Lubotenit, ishte edhe një paralajmërim për sfidën dhe ekspeditën e radhës, sepse në muajin korrik studentët e Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit do të përshkojnë majën më të lartë në Alpet Shqiptare, Majën e Gjeravicës me lartësi mbidetare 2,656 metra.

SHKURTA DHE MIRLINDA, INFERMIERET E DIPLOMUARA NË AAB E TË PUNËSUARA NË GJERMANI

24 Qershor 2021

Shkurta Haliti dhe Mirlinda Uka janë edhe dy studentet e diplomuara në Fakultetin e Infermierisë në Kolegjin AAB, të cilat krahas studimeve kanë qenë edhe pjesë e Programit për Karrierë dhe Punësim, ndërsa sot kanë filluar punën si infermiere në Gjermani.



Ato dhe kolegët e tyre të cilët tash e tre muaj kanë filluar punën në Gjermani, janë shembulli më i mirë i një bashkëpunimi të frytshëm në trinomin AAB, LINGUA dhe partnerët gjerman.

Shkurta dhe Mirlinda, janë shprehur jashtëzakonisht të kënaqura me mikpritjen nga stafi i vendit të tyre të punës, dhe ndihmën që iu është ofruar, qoftë në procesin e punës po ashtu edhe në procesin e integritimit në Gjermani.

Ajo që na bën edhe më krenarë në këtë pikë është edhe vlerësimi që po u bëhet studentëve tanë nga punëdhënësit gjermanë, për nivelin e përgatitjes profesionale nga Kolegji AAB, dhe përgatitjes së gjuhës gjermane dhe të tjera nga stafi i Lingua-s.

Numri i studentëve tanë të cilët po fillojnë punën në klinikat gjermane, partnere të Programit, tanimë nuk janë raste individuale, kjo tashmë po dëshmohet që Kolegji AAB dhe Programi për Karrierë dhe Punësim, do të jetë adresa e vetme e suksesit për infermierët të cilët synojnë tregun gjerman!



KOLEGJI AAB MBAJTI AKADEMI NË 85 VJETORIN E LINDJES SË AKADEMIKUT REXHEP QOSJA

24 Qershor 2021

Kolegji AAB në bashkëpunim me Institutin Albanologjik të Prishtinës, organizuan një akademi me rastin e 85 vjetorit të lindjes së akademik Rexhep Qosjes.



Kolegji AAB
CILËSI. LEADERSHIP. SUKSESI




**Institutit Albanologjik
i Prishtinës**

Akademi

85 vjetori i lindjes së

Akademik Rexhep Qosjes



Në këtë ceremoni ku morën pjesë figura të rëndësishme të institucioneve të Kosovës, intelektualë, studiues, profesorë, studentë e mysafirë të shumtë nga të gjitha trojet shqiptare, akademik Rexhep Qosja u vlerësua lart për kontributin e tij.

Kryeministri i Republikës së Kosovës, z.Albin Kurti, tha se vepra e Qosjes është shumë segmentore.

“Urojmë akademikun Rexhep Qosja në ditëlindjen e tij, shkrimtarin studiuesin dhe intelektualin publik, emrin e përvitshëm të veprës së tij monumentale e cila tashmë është pasuri e gjithë shqiptarëve”, u shpreh Kurti.



Kurti theksoi se vepra e Rexhep Qosjes është e pa moshë, aktuale sot sikurse ka qenë në dekadat e shkuara. Ajo është burim frymëzimi për të rinjtë sot, sikurse ka qenë për të rinjtë e viteve '68, '70-ta, '80-ta, '90-ta, që gjetën nëpër shkrimet e profesor Qosjes arsyen e motivimin për t'u ndjerë krenarë me identitetin shqiptar dhe për t'i rezistuar me trup e me mendje regjimeve shtypëse jugosllave e serbe.



Kryetari i Këshillit Drejtues të Kolegjit AAB, Lulzim Tafa pohoi se Qosja përgjatë viteve është figurë e pakrahasueshme.

“Nisur nga parimet e shoqërisë demokratike që karakterizojnë para së gjithash me shumësi mendimesh, Rexhep Qosja ka ditur të shprish mendimet dhe qëndrimet uniforme të cilat nganjëherë e në raste të caktuara shoqëria jonë i ka ndërtuar”, u shpreh Tafa.



Për veprimtarinë intelektuale e akademike të Rexhep Qosjes, folën edhe historiani nga Shqipëria, Pëllumb Xhufi, drejtori i Institutit Albanologjik të Prishtinës, prof.dr. Hysen Matoshi, si dhe profesori Agim Vinca, të cilët çmuan kontributin e tij për më shumë se 5 dekada.





Vetë akademik Qosja shprehu mirënjohje për këtë ngjarje.

“Ky nderim që po më bëhet sot nga ju, më ka sjellë gëzim. Sepse po më bëhet nga një koleg që është ndër më të mëdhenjtë e më të rëndësishmit në Republikën e Kosovës, që është njëkohësisht institucion i arsimit të lartë, i veprimtarive teatrore e kulturore, e i medias moderne, Kolegjit AAB, dhe nga një nga institutet më të rëndësishme e më të çmuara të studimeve shqiptare, Institutit Albanologjik të Prishtinës”, tha Qosja.

Rexhep Qosja, i lindur më 1936 në Vuthaj të Malit të Zi, është autor i mbi 30 veprave të zhanreve të ndryshme. Një kohë është marrë edhe me politikë aktive dhe ka qenë pjesë e delegacionit kosovar në konferencën e Rambujesë.

U MBAJT TRAJNIMI “PLANIFIKIMI I PROJEKTEVE ZHVILLIMORE” PËR STAFIN AKADEMIK TË KOLEGJIT AAB

24 Qershor 2021

Zyra e Zhvillimit të Projekteve ka organizuar trajnimin dy ditor “Planifikimi i Projekteve Zhvillimore” për stafin akademik të Kolegjit AAB.



Ky trajnim kishte për qëllim ngritjen e kapaciteteve të pjesëmarrësve për planifikimin dhe implementimin e projekteve zhvillimore, të cilat synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së arsimit në kuadër të Kolegjit AAB.

Grupi i parë i pjesëmarrësve u përbë nga 18 profesorë dhe asistentë të Fakulteteve të ndryshme në kuadër të Kolegjit.



Përfshirja aktive e pjesëmarrësve në këtë trajnim, u finalizua edhe me konceptimin e ideve konkrete për projektet e ardhshme të cilat Kolegji AAB synon të zbatojë. Trajnime të avancuara në këtë fushë, do të organizohen në vazhdimësi, për të ndërtuar kështu kapacitete të larta institucionale të planifikimit dhe implementimit të projekteve zhvillimore.

ÇMIMI NDËRKOMBËTAR PËR LETËRSI “ALI PODRIMJA” I KOLEGJIT AAB PËR VITIN 2021 IU NDA SHKRIMTARIT BOSHNIJAK ABDULAH SIDRAN

25 Qershor 2021

Në një ceremoni madhështore të organizuar në Teatrin AAB “Faruk Begolli”, në Kolegjin AAB, ku morën pjesë personalitete të njohura nga institucionet publike, shkrimtarë, artistë, profesorë e studentë si dhe familjarët e poetit të ndjerë Ali Podrimja, Çmimi Ndërkombëtar për Letërsi “Ali Podrimja” i Kolegjit AAB për vitin 2021 iu nda shkrimtarit boshnjak, akademikut Abdulah Sidran.



Në këtë solemnitë, kryetari i Këshillit Drejtues të Kolegjit AAB, Lulzim Tafa, tha se është kënaqësi e madhe që ky Çmim po i ndahet një shkrimtari të njohur jo vetëm në Bosnjë por edhe në Ballkan e më gjërë.

“Zoti Sidran, ju kemi ftuar për t’ ju dhënë Çmimin që mban emrin e mikut tuaj dhe mikut tim “Ali Podrimja”.

Nëse ai është duke na parë tani, jam shumë i sigurt që do të jetë shumë i lumtur. Ju kemi ftuar edhe për një gjë tjetër, për t’ ju thënë faleminderit për brilantet tuaja poetike dhe për artin e madh që i keni dhuruar njerëzimit”, tha Tafa.



Në fjalën e tij, kryeministri Kurti tha se ndjehet i nderuar që merr pjesë në ceremoninë që nderon krijimtarinë artistike të një poeti, me një çmim që mban emrin e një poeti po ashtu të madh.

Kryeministri Kurti tha se nëpërmjet vargjeve z.Sidran na bashkoi me dhimbjet, plagët e katrahurat që mbijetoi populli i tij, e që pak vite më vonë do të bëheshin realiteti dhe e vërteta edhe te populli ynë.

Ai tha se gjurmët që ka lënë z. Sidran në letërsinë boshnjake dhe në atë të Ballkanit janë të pashlyeshme. Ato do t’ i shërbejnë fort kujtesës kolektive të popujve ndaj të cilëve historia shumë herë u tregua e pamëshirshme.

Ndarjen e Çmimit Ndërkombëtar për Letërsi “Ali Podrimja”, për shkrimtarin boshnjak Abdulah Sidran, e vendosi juria në përbërje: Halil Matoshi, Naime Beqiraj, Lulzim Tafa, Rrahman Paçarizi e Vlora Konushevc.



Në arsyetimin e jurisë, të cilin e dha Halil Matoshi, u tha se ky Çmim i ndahet shkrimtarit Abdulah Sidran, për artin e tij të madh duke pasur parasysh vlerësimet dhe konsideratat më të larta për të. Ndërsa Çmimin, fituesit të vitit 2021 ia dorëzoi rektori i Kolegjit AAB, Bujar Demjaha.

Në ceremoninë solemne të ndarjes së Çmimit “Ali Podrimja”, laureati i vitit 2021, mbajti një fjalim emotiv para të pranishmëve.

“Njerëzit rëndom mendojnë se çdo guaskë e marrë nga fundi i detit mban në vete një margaritar. Por jo çdo guaskë ka një margaritar. Margaritar kanë vetëm ato guaska që kanë përjetuar një goditje të jashtme, kanë pësuar plagë të rëndë në trupin e tyre, dhe për ta shëruar atë plagë, ato sekretojnë një lëng të tillë që më vonë shndërrohet në margaritar.



Talentet tona kanë lindur nga një lot, margaritarët tanë kanë lindur nga plagët tona dhe unë dua që të gjithë këtu ta kuptojmë këtë si një e vërtetë që lidhet me individin dhe si një e vërtetë që lidhet me popujt tanë, kolektivitetet tona.

Ajo që është më e bukura në to, ka lindur nga plagët e popujve tanë dhe njerëzve tanë. Dhe të shpresojmë që plagët aktuale të cilat i kemi dhe nëpër të cilat po kalojmë në të ardhmen të japin perla të mrekullueshme dhe të bukura që do të jenë krenaria e njerëzve.

Faleminderit të gjithëve. Unë jam vërtet një njeri i lumtur sonte”, tha Sidran.



Kujtojmë se Çmimin Ndërkombëtar për Letërsi dhe Art “Ali Podrimja” të cilin e ndan Kolegji AAB, deri tani e kanë fituar shkrimtari i madh shqiptar Ismail Kadare dhe shkrimtari i madh malazias Jevrem Bërković.

FAKULTETI I KULTURËS FIZIKE NËNSHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME FEDERATËN E BADMINTONIT TË KOSOVËS

28 Qershor 2021

Edhe një federatë sportive, ajo e Badmintonit, tashmë është pjesë e listës së partnerëve të Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit të Kolegjit AAB.

Me marrëveshjen e nënshkruar nga ana e dekanatit të këtij fakulteti dhe Federatës së Badmintonit të Kosovës, synohet që studentëve të Kolegjit AAB t' u ofrohet edhe një mundësi për realizimin e pjesës teorike e praktike e zhvillimin e njohurive të reja në praktikë, në kuadër të lëndës së Badmintonit që pritët të inkorporohet në projektin e ardhshëm katër vjeçar.



Krahas kësaj, përmes kësaj marrëveshje do të organizohen programe të veçanta akademike afatshkurtra, përfshirë organizimin e përbashkët të shkollave verore, kampeve të ndryshme, manifestimeve të ndryshme, garave të niveleve të ndryshme.



Nga ana tjetër, studentëve të interesuar për licencim për trajner të badmintonit, sipas niveleve, do t' u ofrohet edhe kjo mundësi përmes formave të precizuara të bashkëpunimit.

